



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr.427/13 Prot

Tiranë më 06.09.2018

## VENDIM

**Nr. 28, datë. 06.09.2018**

***“Për miratimin e hapjes së Departamentit të gjuhës greke në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës”***

Bazuar në nenin 38, pika 1/ë dhe në nenin 30, pika 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; pas miratimit të Bordit të Administrimit, me Vendimin nr.42 datë 14.05.2018 “Për miratimin e hapjes së Departamentit të gjuhës greke”, përcjellë me shkresën nr.262 datë 18.05.2018, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 06.09.2018,

## VENDOSI:

1. Miratimin përfundimtar të hapjes së Departamentit të gjuhës greke në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.
2. Departamenti i Gjuhëve sllavo-ballkanike në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT, pjesë e të cilit ka qenë deri tani edhe dega e gjuhës greke, do të vazhdojë të ketë të njëjtin emërtim.
3. Ky Vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda një afati tridhjetëditor.
4. Ky Vendim i përcillet për zbatim Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF.DR.MYNYR KONI**